

## **GJYKATA E APELIT**

**Numri i lëndës: PAKR 13/2014**

**(P nr. 322/09 Gj/Th Prishtinë)**

27 mars 2015

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Manuel Soares, kryetar dhe gjyqtar raportues, gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Mejreme Memaj dhe Xhevdet Abazi, si anëtarë të kolegjit, me asistimin e këshilltares ligjore të EULEX-it Vjollca Kroçi-Gërxhaliu, e cila vepron në cilësinë e procesmbajtëses.

### **I PANDEHURI**

H. U. K., mashkull, shqiptar i xxx i lindur më xxx në xxx, komuna e xxx, me vendbanim në xxx, me numër personal xxx.

### **AKTGJYKIM I GJYKATËS SË APELIT**

Në bazë të nenit 398 të KPP-së<sup>1</sup>, lidhur me ankesën e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, të datës 18 tetor 2013, në lëndën P nr. 322/09, kolegji i Gjykatës së Apelit vendos si në vazhdim:

- 1) Refuzohet ankesa e parashtruara nga mbrojtësi Mustafë Kastrati në emër të të pandehurit H.K., më 19 dhjetor 2013.
- 2) Miratohet ankesa e parashtruar nga prokurori më 25 nëntor 2013;
- 3) Aktgjykimi me numër P nr. 322/09 i Gjykatës Themelore të Prishtinës, i datës 18 tetor 2013, ndryshohet lidhur me vendimin mbi dënimin me sa vijon: i akuzuari H.K. dënohet me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim për veprën penale të Vrasjes së rëndë, në kundërshtim me nenin 147 (5) dhe (9) të KPK-së, që ishte në fuqi deri më 31 dhjetor 2012. Derisa aktgjykimi të marr formën e prerë, koha e kaluar në paraburgim nga data 19 shkurt 2009, do të llogaritet në dënim.

### **ARSYETIMI**

---

<sup>1</sup> Shkurtesat në vazhdim që u referohen kodeve përkatëse, tash e tutje do të përdoren në tekst: kodi i mëparshëm penal: KPK, kodi aktual penal: KPRK, kodi i mëparshëm i procedurës penale: KPPK, kodi aktual i procedurës penale: KPP.

## **1. Përmbledhje e procedurës përkatëse**

Pas zbulimit të viktimës V.S., K., më 18 shkurt 2009, hetimi kishte filluar kundër të pandehurit H.K. për veprën penale të *vrasjes së rëndë*.

I pandehuri ishte arrestuar më 19 shkurt 2009 nga Policia e Kosovës.

Aktakuza ishte ngritur më 16 qershor 2009 me të cilën i pandehuri akuzohej për *vrasje të rëndë* në kundërshtim me nenin 147 (5) dhe (9) të KPK-së. Aktakuza ishte konfirmuar më 18 janar 2010.

Shqyrtimi gjyqësor kishte filluar më 7 maj 2010 dhe u mbajtën disa seanca deri më 27 shkurt 2013.

Pas caktimit të lëndës gjyqarëve të EULEX-it, shqyrtimi gjyqësor kishte filluar sërish më 9 shtator 2013 dhe ishte ndërprerë më 18 tetor 2013, me shpalljen e aktgjykimit. I pandehuri ishte shpallur fajtor ashtu sikurse edhe ishte akuzuar dhe u dënua me 22 vjet burgim.

Mbrojtësi Mustafë Kastrati ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit në emër të të pandehurit më 19 dhjetor 2013.

Edhe prokurori ka parashtruar ankesë kundër aktgjykimit më 25 nëntor 2013.

Mendimi i prokurorit të apelit ishte paraqitur në Gjykatën e Apelit më 13 janar 2014.

Seanca e hapur dhe këshillimi i kolegjit të apelit ishin mbajtur më 1 tetor 2014.

Për shkak të çështjeve administrative që kanë të bëjnë me caktimin zyrtar të kolegjit të apelit, aktgjykimi me shkrim i cili ishte përfunduar pas këshillimit të mbajtur më 1 tetor 2014, është nënshkruar dhe kryer vetëm më 27 mars 2015.

## **2. Akuzat e ngritura ndaj të pandehurit**

*Vrasje e rëndë*, në kundërshtim me nenin 147 (5) dhe (9) të KPK-së.

## **3. Aktgjykimi në shkallën e parë**

I pandehuri ishte shpallur fajtor për *vrasje të rëndë* në kundërshtim me nenin 147 (5) dhe (9) të KPK-së dhe ishte dënua me 22 vjet burgim sepse më 17 shkurt 2009, në mes orës 15:30 dhe 17:00, në pyllin e fshatit Zllatar, komuna e Prishtinës, i pandehuri duke vepruar pamëshirshëm dhe dhunshëm për motive të ulëta, e ka goditur vazhdimisht me një mjet të fortë në kokë dhe trup V.S.n-Krasniqin duke i shkaktuar lëndim të rëndë trupor, dëmtime të tjera shpuese dhe prerje të thella, hematome në pjesë të ndryshme të trupit, thyerje të kafkës si edhe lëndime të tjera të rënda në tru duke e privuar në këtë mënyrë viktimën nga jeta.

## **4. Parashtrësit e palëve**

Ankesa e mbrojtësit

Mbrojtësi kundërshton aktgjykimin e kundërshtuar për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës, shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj ai i propozon gjykatës ta miratojë ankesën në tërësi dhe ta prish aktgjykimin e kundërshtuar dhe lëndën ta kthejë në rigjykim, ose ta ndryshojë atë ashtu që të shpallë aktgjykimin lirues. Ai po ashtu propozon që të ndërpritet paraburgimi.

#### Ankesa e prokurorisë

Prokurori i propozon Gjykatës së Apelit ta ndryshojë aktgjykimin në mënyrë që ta dënojë të pandehurin me një dënim më të rëndë. Ai e konsideron dënimin e shqiptuar jo adekuat duke pasur parasysh rrezikun social të veprës penale.

#### Mendimi i prokurorit të apelit

Prokurori i apelit i propozon Gjykatës së Apelit ta pranojë ankesën e prokurorit dhe ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar me qëllim që të shqiptojë një dënim më të lartë ndaj të pandehurit.

### **5. Ligji i zbatueshëm procedural**

Aktgjyrimi i shkallës së parë ka zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës i cili ka qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2012 (KPPK) bazuar në supozimin se shqyrtimi gjyqësor ka filluar në 2009. Ky supozim nuk është i saktë. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 7 maj 2010, por lënda ishte marrë nga EULEX-i dhe gjyrimi ka rifilluar më 9 shtator 2013, kur KPP-ja ishte tanimë në fuqi.

Sipas nenit 540.2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) që është në fuqi nga 1 janar 2013, kodi i ri është i zbatueshëm në procedurat për të cilat aktakuza ishte konfirmuar para datës 1 janar 2013 dhe shqyrtimi gjyqësor ka filluar pas kësaj date. Në procedurën aktuale aktakuza ishte konfirmuar më 18 janar 2010 dhe shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 9 shtator 2013. Sipas mendimit të kolegjit të apelit, interpretimi i duhur i dispozitave të zbatueshme kalimtare përcakton se është i aplikueshëm kodi i ri i procedurës penale. Pra të gjitha veprimet hetimore të kryer nga gjykata dhe palët duhet të vlerësohen dhe vendosen në kuadër të këtij interpretimi.

### **6. Pranueshmëria e ankesës**

Gjykata e Apelit konsideron se ankesat ishin ushtruar në kohë nga personat e autorizuar, në përputhje me nenet 374.1.1 dhe 380.1 të KPP-së.

### **7. Çështje meritore të ankesave**

#### **7.1. Ankesa e mbrojtjes**

Marrë në përgjithësi, në shumë aspekte relevante, ankesa nuk është tërësisht e qartë dhe nuk është mjaftueshëm e arsyetuar. Arsyet ligjore nuk janë paraqitur me një renditje logjike. Çështjet në disa aspekte madje edhe janë përzier e ngatërruar. Duhet të vihet në pah se për ta kundërshtuar një aktgjykim për çështje të cilat nuk mundë të shqyrtohen *ex officio* nuk është e mjaftueshme të

pohohet njëherë e mirë se aktgjykimi i shkallës së parë është i gabueshëm në këtë apo atë aspekt. Është më se e nevojshme që të tregohet pse është i gabueshëm dhe sa më shumë që të jetë e mundshme për të qenë i saktë dhe i qartë për kualifikimin dhe shpjegimin e arsyeve ligjore për ta kundërshtuar atë. Ky është obligim i palëve që del nga detyra për të sjellë “një përshkrim të bazës ligjore për mjet” dhe “arsyet për kundërshtimin e aktgjykimit” (nenet 376 1.6 dhe 382.1.2 të KPP-së). Nga gjykata e cila shqyrton aktgjykimin nuk pritet që të gërmojë në formulimin e parashtrësive për të ia qëlluar dëshirës së ankuesit.

Përkundër këtij fakti, Gjykata e Apelit në vazhdim do t'i shtjellojë të gjitha çështjet e kundërshtuara në ankesën e mbrojtësit. Për ta bërë këtë në mënyrë sa më të logjikshme dhe të kuptueshme, çështjet do të vendosen në bazë të rendit të përcaktuar me ligj.

### **7.1.1. Shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale**

#### Përdorimi i provave të papranueshme duke iu referuar nenit 384.1.8 të KPP-së

Para se ta adresojë secilën provë të cilën parashtruesi i ankesës e konsideron të papranueshme, Gjykata e Apelit dëshiron të theksojë një aspekt të rëndësishëm lidhur me vlefshmërinë e provave. Sipas nenit 257.2 të KPP-së, provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu. Pra jo të gjitha shkeljet e dispozitave procedurale i bëjnë doemos provat e papranueshme. Kur ligji nuk e përcakton atë pasojë, shkelja esenciale e procedurës në mbledhjen e provave mund të ndodhë vetëm nëse një shkelje e tillë e dispozitave procedurale ka pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, në përputhje me nenin 384.2 të KPP-së.

Duke pasur këtë parim në konsideratë, kolegji i apelit tani do ta trajtojë çdonjërin nga shkaqet e pohuar për pavlefshmërinë e provave.

Parashtruesi i ankesës ka pohuar se deklarata e tij e datës 19 shkurt 2009 ishte dhënë në polici nën shtrëngim fizik. Kjo çështje në fakt ishte ngrit nga mbrojtja në shkallën e parë por trupi gjykues e ka refuzuar kërkesën (shih paragrafët 21-24 të aktgjykimit).

Nuk ka asnjë dyshim se deklarata e dhënë nën shtrëngim është e ndaluar dhe e papranueshme sipas nenit 257.4.1 të KPP-së. Gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata ka shqyrtuar disa prova për të verifikuar nëse pohimi i të pandehurit mund të vërtetohet. Një dëshmitar ishte ftuar, ishte shqyrtuar raporti mjekësor dhe ishte analizuar deklarata e kontestuar. Aktgjykimi ka vërtetuar se deklarata e të pandehurit ishte dhënë në mënyrë vullnetare dhe të lirshme dhe ka shpjeguar në hollësi se si ishte arritur deri në këtë përfundim. Aty nuk ishte asnjë element të vetëm të besueshëm për ta bazuar pohimin e shtrëngimit. Edhe mbrojtësi i pranishëm gjatë kohës kur ishte dhënë deklarata edhe raporti mjekësor i përgatitur në kohën kur ishte burgosur i pandehuri, tregojnë se një gjë e tillë kurrë nuk kishte ndodhur. Kolegji i apelit plotësisht pajtohet me këtë vlerësim.

Parashtruesi i ankesës po ashtu ka pohuar se mbrojtësi nuk ishte i njoftuar dhe nuk ishte i pranishëm gjatë procedurës së identifikimit të dëshmitarëve H.T.dhe N. G. Ky kundërshtim ishte trajtuar në aktgjykim (shih paragrafët 25-27).

Në kohën kur ishte zhvilluar procedura e identifikimit, më 17 dhe 19 mars 2009, një veprim i tillë hetimor ishte vendosur me nenin 255 të KPPK-së. Duke i lexuar dokumentet përkatëse, kolegji i apelit pajtohet me konkluzionin në aktgjykim dhe konsideron se policia hetuese i ka ndjekur së afërmi këto kushte. Prania e mbrojtësit nuk ishte e detyrueshme në të gjitha veprimet hetimore sipas dispozitave të zbatueshme. Prokuroria ishte e obliguar vetëm që ta thërras të pandehurin dhe/ose mbrojtësin për këto veprime: marrjen në pyetje të të pandehurit (neni 231 (3) të KPPK-së), mundësinë hetuese të veçantë (neni 165 (1), *ex vi* neni 238 (3) i KPPK-së), bastisje (neni 243 (1) i KPPK-së) dhe këqyrja të vendit ose ri-konstruksion (neni 254 (3) i KPPK-së). Lidhur me identifikimin e personave dhe objekteve, ligj nuk përmban asgjë rreth obligimit për ta thirrur mbrojtësin e që në realitet nënkupton se kjo nuk ishte e detyrueshme (neni 255 i KPPK-së). Bile edhe nëse rregullat për marrjen në pyetje të dëshmitarëve do të zbatoheshin sipas analogjisë, mundësia e tillë është lënë në dorë të prokurorisë (neni 237 (4) i KPPK-së). Pra sipas mendimit të kolegjit të apelit, nuk ka ndodhur asnjë shkelje procedurale.

Së fundi, parashtruesi i ankesës ka pohuar se mbledhja e provave në vendin e ngjarjes ishte e papranueshme. Nuk është dhënë asnjë shpjegim tjetër lidhur me arsyet për bazën e asaj papranueshmërie. Aktgjykimi e ka vendosur këtë kundërshtim (shih paragrafët 28-29).

Veprimet e ndërmarra nga policia në vendin e ngjarjes ishin mbuluar me dispozitat e nenit 201 të KPPK-së. Me sa duket i pandehuri pohon se ai ka qenë dashur të njoftohet për të drejtën e pjesëmarrjes në këto veprime hetimore por kjo nuk ka asnjë kuptim. Në kohën kur policia i ka mbledhur provat në vendngjarje nuk kishte njohuri të mjaftueshme rreth identitetit të kryerësit. Për këtë arsye është më se e qartë se policia nuk ka mundur ta njoftojë të pandehurin në cilësinë e tij të të dyshuarit. Në këtë aspekt, kolegji i apelit pajtohet me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

#### Aktgjykimi e ka tejkalluar akuzën duke iu referuar nenit 384.1.10 të KPP-së

Mbrojtësi pohon se aktgjykimi ka tejkalluar akuzën sepse ishte vërtetuar se i pandehuri e ka vrarë viktimën me një mjet tjetër nga ai i përmendur në akuzë.

Aktakuza duhet të përmbajë gjithësi përshkrimin faktik të veprës penale. Kjo mund të ndryshohet nga prokuroria gjatë shqyrtimit gjyqësor sipas neneve 241.1.4 dhe 350 të KPP-së. Në kësi rasti, i akuzuari doemos duhet ta ketë mundësinë për ta përgatitur dhe paraqitur mbrojtjen. Përshkrimi faktik në aktakuzë është i një rëndësi të madhe për ta kufizuar qëllimin e akuzës dhe për të lejuar ushtrim të duhur dhe efektiv të të drejtave të mbrojtjes. Megjithatë, në kundërshtim të asaj që është pohuar në ankesë, nuk kishte ndryshim të aktakuzës. Është e parëndësishme nëse gjatë fjalës përfundimtare prokurori do të mendonte ndryshe nga jo që ka menduar në aktakuzë rreth fakteve. Çdo ndryshim i aktakuzës do të duhej të bëhej sipas një propozimi formal në gjykatë, gjë e cila asnjëherë nuk ka ndodhur.

Raporti i autopsisë përmend një “send të fortë të mprehtë” si mjet i krimit. Askund nuk përmendet “tulla për ndërtim” sikurse pohohet në ankesë. Sipas aktakuzës i pandehuri akuzohet për vrasje të viktimës me një “send të rëndë”, që ishte një “shufër hekuri”. Në aktgjykim ishte vërtetuar se vrasja ishte kryer me një “send të rëndë”. Kolegji i apelit konsideron se nuk është bërë tejkallim i akuzës. Edhe pse është e pakontestueshme se aktgjykimi mund të ndërlihet vetëm me faktet që përfshihen

në akuzë (neni 360.1 i KPP-së), ndryshimi i gjendjes faktike duhet të jetë përmbajtjesor dhe në gjendje për të ndikuar në mënyrë efektive në të drejtat e mbrojtjes. Fjalët e ndryshme për ta përshkruar të njëjtin fakt nuk përbëjnë një shkëlqje të tillë, sepse koncepti i “faktit” ndërlidhet me ngjarje të zakonshme specifike ose veprime njerëzore të vendosura në kohë dhe hapësirë dhe jo fjalë që përdoren për ta përshkruar atë. Ajo që është e rëndësishme është dhënia e të pandehurit informacione të nevojshme në mënyrë që ai paraprakisht të jetë në dijeni se për cilat fakte vendimtare ai ose ajo akuzohet, për t’i lejuar atij ose asaj t’i kundërshtojë këto fakte dhe për të paraqitur prova përkatëse mbështetëse. Pas leximit të aktgjykimit, Gjykata e Apelit është e mendimit se asnjë ndryshim përkatës i fakteve në dëm të të pandehurit nuk përfshihet në dispozitiv.

### Shkeljet e tjera procedurale duke iu referuar nenit 384.2 të KPP-së

Parashtruesi i ankesës ka ngritur katër çështje të tjera për ta kundërshtuar saktësinë e procedurës. Sikurse u përmend më sipër, vetëm shkëlqja e procedurës e cila ka ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë mund të konsiderohet si substanciale. Kolegji i apelit tani do t’i trajtojë këto çështje.

Ankesa i referohet jurisprudencës së KEDNj lidhur me parimin e një gjykimi të drejtë përgjatë një periudhe të arsyeshme kohore që ka rezultuar në dëm të situatës të të akuzuarit. Nuk është e qartë se cili është epilogu të cilin parashtruesi i ankesës kërkon ta sigurojë me ngritjen e kësaj çështjeje respektivisht nëse ai propozon që aktgjykimi të ndryshohet ose priset mbi bazën e këtij motivi.

Kolegji i apelit pa dyshim pajtohet se procedura në fazën e shqyrtimit gjyqësor ka pësuar vonesë të paarsyeshme. Kjo edhe ishte arsyeja për të cilën EULEX e mori lëndën më 26 gusht 2013, pasi që gjykimi ishte në pritje për më shumë se 3 vjet. Pas kësaj kohe, kolegji i ri ka përfunduar gjykimin në më shumë se një muaj e që është periudhe kohore e arsyeshme dhe e duhur. Një vonesë tjetër ka ndodhur në fazën e apelit për shkak të çështjeve zyrtare që u përmendën më sipër. Pavarësisht faktit se vonimi i procedurës përtej periudhës së arsyeshme kohore është cenim i të drejtave, kjo, po që se nuk ka pasoja në çështjet meritore të vendimit, nuk përbën shkëlqje procedurale. Një aktgjykim liruës nuk mund të bazohet në këtë arsye dhe prishja e tij do të kishte për epilog dëm më të madh në të drejtat e të pandehurit sepse do të qonte në një situatë për të cilën vonesa do të ishte bile edhe më e gjatë.

Parashtruesi i ankesës ka pohuar se i pandehuri është privuar nga e drejta për të parashtruar ankesë për shkak se gjykata e shkallës së parë nuk ka nxjerr një aktvendim të ndarë mbi propozimin e tij për t’i hedhur poshtë provat si të papranueshme.

Një aktvendim i ndarë mbi kundërshtimet në prova lëshohet para fillimit të shqyrtimit gjyqësor sipas dispozitave të nenit 249.3 të KPP-së. Rrjedhimisht, trupi gjykues ende mund t’i refuzojë provat si të papranueshme ose *ex officio* ose sipas parashtrësës së palës por asnjë dispozitë e ligjit nuk e parasheh nevojën për të nxjerrë një aktvendim të ndarë. Përkundrazi nga nenet 260.1,2 dhe 370.7 të KPP-së del se vlerësimi i provave, përfshirë këtu edhe vendimin mbi pranueshmërinë e tyre, mund të bëhet në aktgjykim. Mbrojtja nuk është privuar nga e drejta për ta kundërshtuar vendimin sepse ligji pranon ankesën kundër aktgjykimit bazuar në përdorimin e provave të papranueshme. Pra ky argument i ankuesit është disi i çuditshëm dhe pa dyshim kundërthënës. Në të njëjtën

parashtrësë me të cilën e ankimon pranimin e provave, ai pohon se nuk ka mundur të parashtrrojë ankesë për ta ngritur këtë pohim.

Parashtruesi i ankesës ka kundërshtuar edhe faktin se ai është ndërprerë dhe i është kërkuar ta shkurttojë fjalën e tij përfundimtare në kundërshtim me të drejtat e mbrojtjes.

Ligji është i qartë dhe parasheh se fjala përfundimtare mund të jetë subjekt i afateve kohore të caktuara nga kryetari i trupit gjykues dhe madje edhe të ndërpritet nëse pala përmend çështje të cilat në mënyrë të qartë janë të parëndësishme ose që shkaktojnë vonim të procedurës. (neni 356 i KPP-së). Në mënyrë të dukshme, përdorimi i këtyre prerogativave duhet të udhëhiqet nga një ekuilibër i arsyeshëm më mes të shpejtësisë së nevojshme të gjykimit dhe të drejtave të mbrojtjes. Mbrojtësit të të pandehurit i është pranuar mundësia për të paraqitur me shkrim fjalën përfundimtare që është në shkresat e lëndës. Kolegji i apelit e ka lexuar procesverbalin dhe është i mendimit se kryetari i trupit gjykues ka vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe se nuk ka pasur cenim të të drejtave të mbrojtjes.

Së fundi, parashtruesi i ankesës ka pohuar se gjykata nuk ka marrë asnjë vendim për kërkesën e tij për ta liruar të pandehurin nga paraburgimi.

Ky deklaram nuk është i saktë, pasi që aktvendimi me të cilën ishte vazhduar paraburgimi derisa vendimi të marr formën e prerë, ishte nxjerrë më 18 tetor 2013.

### **7.2.2 Vërtetim i gabueshëm dhe jo i plotë i gjendjes faktike**

Shqyrtimi i vendimit të shkallës së parë lidhur me vërtetimin e fakteve është i kufizuar me pohimet e parashtruesit të ankesës. Kjo nuk çështje të cilën Gjykata e Apelit mund ta shqyrtojë *ex officio* (neni 394.1 i KPP-së *a contrario sensu*). Pala duhet të jap motivim të saktë për ankesën dhe ta sqaroj në mënyrë të qartë se cilat prova do të tregonin se një fakt i caktuar duhet të ishte konsideruar i provuar ose jo i provuar dhe pse. Ligji nuk ua pranon palëve të drejtën për një aktgjykim të dytë për të njëjtat prova por rishqyrtimin e mënyrës se si është vërtetuar. Sikurse më parë është vërtetuar nga Gjykata e Apelit<sup>2</sup>, termet “vërtetim i gabueshëm i gjendjes faktike” dhe “vërtetim jo i plotë i gjendjes faktike” u referohen gabimeve ose lëshimeve që ndërlidhen me “faktet vendimtare” e të cilat janë kyçe për aktgjykimin e marrë<sup>3</sup>. Vetëm po që se gjykata e shkallës së parë bën gabim fundamental gjatë vlerësimit të provave dhe vërtetimit të fakteve, atëherë Gjykata e Apelit do ta ndryshojë aktgjykimin<sup>4</sup>.

Si parim i përgjithshëm, vlerësimi i provave duhet të mbështetet në vlerësimin e drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm të dëshmimeve verbale dhe deklaratave të kolegjit të gjyqtarëve. Të lexuarit e procesverbalit të provave të shqyrtuara në gjykim, sado që mund të jetë besnik dhe i saktë, është gjithnjë instrument më pak i besueshëm vlerësues. Qoftë edhe ekzaminimi i dokumenteve dhe i provave të tjera materiale në përgjithësi është më i saktë në gjykim ngase shpesh këto prova duhet të analizohen në raport me elementet e tjera dhe varen nga shpjegimet orale nga dëshmitarët apo

<sup>2</sup> PAKR 1121/12, aktgjykimi i datës 25/09/2013.

<sup>3</sup> Aktgjykimi i përmendur i referohet B. Petric, në: Komentimet e neneve të ligjit jugosllav të procedurës penale, botimi i dytë 1986, neni 366, para. 3.

<sup>4</sup> PaKr 1122/12, aktgjykimi i datës 25 prill 2013.

palët. Për këtë arsye, siç është vërtetuar nga gjykata në fjalë edhe në rastet e tjera<sup>5</sup>, “Është parim i përgjithshëm në procedurën e apelit që Gjkata e Apelit duhet patjetër të tregojë një dozë respekti ndaj gjetjes faktike të trupit gjykues për arsye se ky i fundit ka qenë në pozitë më të mirë për t’i vlerësuar provat në fjalë.” Gjkata Supreme e Kosovës është e mendimit se duhet patjetër “ta respektojë vlerësimin e bërë nga trupi gjykues lidhur me besueshmërinë e dëshmitarëve të gjykimit të cilët janë paraqitur personalisht para tyre dhe të cilët kanë dëshmuar personalisht para tyre. Nuk i shkon Gjykatës Supreme të Kosovës që të kalojë mbi vlerësimin e trupit gjykues lidhur me besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve nëse nuk ka ndonjë bazë të shëndoshë për të bërë diçka të tillë.” Standardi të cilin e ka aplikuar Gjkata Supreme ka qenë “të mos preken gjetjet e gjykatës që e ka gjykuar lëndën nëse ndonjë gjykatë faktike nuk i ka pranuar provat mbi të cilat është mbështetur gjykata e cila e ka gjykuar lëndën, ose në rastet kur vlerësimi i saj ka qenë tërësisht i gabueshëm”.<sup>6</sup>

Kolegji i apelit i ka rishikuar të gjitha provat e shqyrtuara nga gjykata e shkallës së parë dhe vlerësimin e bërë nga kolegji në aktgjykimin në fjalë. Është e qartë se çdoherë mund të gjenden kontradikta apo mospërputhje, në veçanti në qoftë se një provë e caktuar zbardhet nxirret jashtë kontekstit të përgjithshëm, duke i injoruar informatat tjera përkatëse dhe rregullat e interpretimit në bazë të arsyes së shëndoshë dhe logjikës. Kjo ka mundësi të bëhet në të gjitha lëndët, në veçanti kur faktet kanë të bëjnë me ngjarjet për të cilat nuk ka dëshmitarë të drejtpërdrejtë dhe kur gjykata duhet patjetër të mbështetet në provat rrethore dhe jo të drejtpërdrejta.

Aktgjykimi, sipas opinionit të kolegjit të apelit, nuk përmban ndonjë gabim të madh në vlerësimin e provave dhe në vërtetimin e fakteve. Ankuesi nuk ka treguar se trupi gjykues ka gabuar apo nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Krejt çfarë ankuesi ka bërë është se i ka zbardhur disa pjesë specifike të provave të cilat i ka konsideruar se janë në favor të të pandehurit, për të nxjerrë konkluzionet të cilat nuk janë të pranueshme.

Faktet e kontestueshme nuk janë dëshmuar drejtpërsëdrejti. I pandehuri ka dhënë dy dëshmi të kundërta lidhur me faktet në fjalë. Rrjedhimisht, gjykata e shkallës së parë është dashur të mbështetet në provat jo të drejtpërdrejta apo rrethore, por ky është instrument i vlefshëm dhe i ligjshëm për të çuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Numri i provave rrethore është i rëndësishëm. Të gjitha elementet rrethore janë kompatible dhe përputhen njëri me tjetrin. Të gjitha provat jo të drejtpërdrejta çojnë tek konkluzionet e njëjta. Nuk ekziston asnjë provë e drejtpërdrejtë, e cila e kundërshton në mënyrë vendimtare aktgjykimin fajësues. Vlerësimi i provave si një tërësi, sipas kriterëve të logjikës së shëndoshë, e mbështet konkluzionin mbi fajësinë e të pandehurit. Nuk ekziston asnjë sqarim i besueshëm dhe i arsyeshëm për ekzistimin e provave.

Deklaratat e të pandehurve dhe të dëshmitarëve, të dyja të dhëna në fazën hetimore dhe në shqyrtimin gjyqësor, janë shqyrtuar hollësisht nga gjykata e shkallës së parë. E njëjta gjë ka ndodhur me regjistrimin e komunikimeve telefonike dhe me transkriptimin e SMS-ve. Provat e dokumentuara dhe ato të mjekësisë ligjore po ashtu janë vlerësuar me kujdes. Aktgjykimi e

---

<sup>5</sup> Aktgjykimi PAKR 1121 / 12, i datës 25/09/2013.

<sup>6</sup> Gjkata Supreme e Kosovës, AP - KZi 84 / 2009, 3 dhjetor 2009, paragrafi 35; Gjkata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2 / 2012, 24 shtator 2012, paragrafi 30.



shpjegon në detaje domethënien e këtyre provave dhe të kundërshtive në mes tyre. Këtë gjë e bën në mënyrë bindëse që e shtyn kolegjin e apelit për të pranuar se gjetjet faktike në aktgjykim janë i vetmi sqarim i arsyeshëm, logjik dhe i mundshëm i provave në fjalë. Si përfundim, nuk është gjetur se aktgjykimi përmban vërtetim të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Është e qartë se mohimi nga i pandehuri i vërtetësisë së deklaratës së tij të parë të dhënë para hetuesve policorë më 19 shkurt 2009 nuk është i besueshëm. Siç është shpjeguar në aktgjykim, i pandehuri ka dhënë detaje lidhur me ngjarjet në fjalë të cilat vetëm ai ka mundur t'i dijë dhe kjo përputhet me provat tjera vendimtare vërtetuese. Për shembull, kush tjetër ka mundur ta dijë se xhaketa dhe kuleta e viktimës ishin të hedhura disa metra larg trupit? Është e qartë se ky detaj në deklaratën e të pandehurit nënkupton se ai ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes në momentet kritike. Më vonë, ai ka dhënë një dëshmi tjetër lidhur me ngjarjet para prokurorit, më 17 mars 2009, në parim duke i mohuar të gjitha që i kishte thënë më herët. Më 9 shtator 2009, gjatë seancës konfirmuese, ai kishte një sjellje të çuditshme që më vonë u vërtetua se nuk kishte të bënte me kurrfarë çrregullimi mendor. Më 18 tetor, kur e kishte dhënë dëshminë para trupit gjykues, ai madje edhe e kishte mohuar se kishte dhënë deklaratë para prokurorit duke pohuar se nënshkrimi i tij në procesverbal ishte falsifikuar. Ai po ashtu e kishte mohuar se SMS-të ishin dërguar nga telefoni i tij dhe se ai nuk kishte komunikuar me viktimën ditën kritike. Në fazën e apelit ai kishte deklaruar para kolegjit të apelit se vrasësit e vërtetë janë në liri dhe se policia e din kush janë ata porse nuk është duke i kryer hetimet e duhura. Kolegji i apelit konstaton se ndryshimet e njëpasnjëshme të deklaratave të dëshmitarit janë vetëm një përpjekje për të krijuar huti dhe për të ngritur dyshime. Është e drejtë e tija që të veprojnë kështu, porse ai nuk mund të presë nga gjykata që t'i injorojë provat aq të fuqishme kundër tij.

Ankuesi deklaroi se asnjë dëshmitar nuk e ka parë të pandehurin duke e vrarë viktimën. Nuk ekziston asnjë dispozitë në ligj e cila kërkon dëshmitarë okularë për ta vërtetuar fajësinë e vrasësit. Aktgjykimin e shpjegon se i pandehuri është parë bashkë me viktimën ditën kritike në një mënyrë e cila nuk lë dyshime se ai dhe viktimja e kishin pasur një diskutim së bashku para se ajo të vritej. Në kundërshtim me pohimet në ankesë, i pandehuri është identifikuar si personi që kishte qenë së bashku me viktimën.

Kolegji i apelit, prandaj, është i mendimit se aktgjykimin nuk përmban vërtetim të gabueshëm apo jo të plotë të fakteve.

### **7.1.2 Shkelja e ligjit penal**

Ankesa e mbrojtësit e kundërshton aktgjykimin në bazë të shkeljes së ligjit penal por nuk ngre asnjë çështje që lidhet me nenin 385 të KPP-së.

Po ashtu, kolegji i apelit nuk gjen asnjë shkelje e cila duhet të adresohet *ex officio*.

Faktet e vërtetuara i plotësojnë të gjitha elementet e veprës penale për të cilat i pandehuri është shpallur fajtor dhe është dënuar. Kolegji i apelit konstaton se pohimet e bëra në ankesë janë jomeritore.

### **7.1.3 Caktimi i gabueshëm i dënimit (neni 386 i KPP-së)**

Dënimi prej 22 vjetësh burgim, i caktuar ndaj të pandehurit është kundërshtuar nga ana e prokurorit. Në ankesën e prokurorisë është argumentuar se dënimi është shumë i butë dhe nuk i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese.

Në bazë të neneve 147 (5) dhe (9), 37 (2) dhe 38 (1) të KPK-së në fuqi kur ka ndodhur veprimi në fjalë, vepra penale ka qenë e dënueshme me burgim prej 10 deri në 20 vjet apo prej 21 deri në 40 vjet. Përderisa sipas neneve 179.1.8 dhe 45.1 të KPRK-së në fuqi nga viti 2013, e njëjta vepër penale tash është e dënueshme me burgim prej 10 deri në 25 vjet burgim apo me burgim të përjetshëm. Është e pakontestueshme se dënimi sipas kodit në fuqi në kohën kur është kryer krimi është më i butë. Gjykata e shkallës së parë prandaj ka pasur të drejtë kur ka vendosur se ligji më i favorshëm i zbatueshëm në këtë lëndë është KPK-ja.

Për më tepër, në mënyrë paradoksale, përkundër faktit se afatet e burgimit janë të ndryshme në KPK dhe në KPRK, trupi gjykues i shkallës së parë e ka vërtetuar në aktgjykim se duke i pasur parasysh të njëjtat rrethana rënduese dhe lehtësuese, sipas rregullave të të dyja kodeve në fjalë dënimi adekuat do të kishte qenë i njëjtë. Kjo nuk është e saktë. Shkallëzimi i dënimit specifik është domosdoshmërisht ndryshe nëse afatet e zbatueshme ligjore ndryshojnë në mënyrë të dukshme.

Për të vendosur nëse prokuroria ka të drejtë duke e theksuar se rrethanat përkatëse për matjen e dënimit nuk janë vlerësuar drejt, kolegji i apelit e sheh të arsyeshme që t'iu adresohet shkurtimisht parimeve përkatëse të zbatueshme, duke i pasur parasysh dispozitat e KPK-së.

Ligji penal është mundësia e fundit për t'i mbrojtur vlerat shoqërore dhe nuk mund të ndërhyjë përtej asaj çfarë është e domosdoshme. Kjo do të thotë se një rregull sanksionuese penale nuk duhet ta tejkalojë domosdoshmërinë e zbatimit të drejtësisë dhe të mbrojtjes së vlerave shoqërore. Në bazë të këtij parimi të domosdoshmërisë së sanksionit penal, caktimi i dënimit duhet të marrë për bazë se dënimi më i ulët i përcaktuar me ligj do të jetë i mjaftueshëm dhe adekuat si pikë fillestare për situatat standarde, të cilat mund t'i nënshtrohen dispozitës fajësuese juridike.

Dënimi është i varur nga qëllimet e parandalimit individual dhe rehabilitimit dhe parandalimit të përgjithshëm. Qëllimet e tija kryesore janë ta parandalojnë kryerësin nga përsëritja e veprës penale dhe t'i përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, duke shprehur mospajtim shoqëror për shkeljen e vlerave të mbrojtura shoqërore (neni 34 i KPK-së).

Gjatë caktimit të dënimit, duhet të merret parasysh se burgimi afatgjatë zbatohet vetëm në krimet më të rënda të kryera me qëllim dhe atë në rrethana posaçërisht të rënda apo duke shkaktuar pasoja veçanërisht të rënda (neni 37 (1) i KPK-së).

Duke e pasur parasysh parimin e proporcionalitetit të vërtetuar me nenin 33.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përderisa duke e caktuar dënimin brenda limiteve ligjore, sanksioni nuk mund të tejkalojë fajin e kryerësit, apo të jetë më i ulët sesa i domosdoshëm për të siguruar parandalimin individual apo atë të përgjithshëm. Caktimi i tij duhet të marrë parasysh të gjitha rrethanat specifike lehtësuese apo rënduese, zaten ato të numëruara në nenin 64 të KPK-së, që

lidhen me veprimin kriminal, me sjelljen e kryerësit më herët, gjatë dhe pas krimit, si dhe me rrethanat e tija personale dhe shoqërore.

Trupi gjykues i shkallës së parë ka shqiptuar burgim afatgjatë prej 22 vjetësh, por nuk ka dhënë arsytim pse janë plotësuar kushtet e nenit 37 (1) të KPK-së. Aktgjykimi gjithashtu nuk ka dhënë motivim të detajuar për masën e dënimit, siç ka qenë i detyruar me nenin 370.8 të KPP-së. Disa rrethana përkatëse që kanë të bëjnë me caktimin e dënimit janë përmendur ama pa ndonjë indikacion të saktë të vlerës apo kuptimit të tyre. Për ligjin nuk është e mjaftueshme vetëm nëse i përshkruan apo i tregon në mënyrë neutrale rrethanat lehtësuese apo ato rënduese, pasi që kjo nuk është shpjegim i arsyeve të cilat kanë çuar deri tek vendimi për shqiptimin e një afati të caktuar të burgimit brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj.

Disa prej rrethanave rënduese dhe lehtësuese të cilat gjykata i ka konsideruar, nuk janë madje as të pranueshme sipas kriterëve ligjore. Nuk është e saktë të pohohet se një lidhje dashurie me një anëtar të familjes është lidhje e kontestueshme prandaj edhe rrethanë rënduese. Pasi që lidhja në fjalë e dashurisë në mes të të pandehurit dhe viktimës nuk ka qenë e kundërligjshme, gjykata nuk mund ta konsiderojë moralisht të kontestueshme lidhjen në fjalë, ngase nuk është roli i saj që të caktojë standarde morale të sjelljes, duke i cilësuar cilat janë moralisht të mira e cilat të këqija. Gjukata mund të imponojë vetëm ato vlera morale dhe / apo etike të cilat janë të mbrojtura me ligj.

Po ashtu edhe fakti që i pandehuri ka kaluar një kohë shumë të gjatë në paraburgim nuk mund të shfrytëzohet si faktor lehtësues, ashtu që gjykata të shqiptojë një dënim më të butë si “kompensim për shkeljen e të drejtave të tija njerëzore.” Nuk është e drejtë që të ulet dënimi për këtë arsye sepse kompensimi i këtij privimi nga liria me këtë po bëhet përmes kësaj periudhe kohore të dënimit dhe jo në të vërtetë përmes uljes së dënimit përfundi kufirit të tij normal dhe adekuat.

Gjukata e Apelit tash do t'i adresojë elementet e rëndësishme në dispozicion për ta përcaktuar dënimin adekuat.

Çështja e parë për të vendosur është nëse janë plotësuar kushtet për caktimin e burgimit afatgjatë të përcaktuar me nenin 37 (1) të KPK-së. Vepra penale ka qenë një prej veprave më të rënda në kod dhe në kundërshtim me vlerën më të rëndësishme të mbrojtur, e cila është jeta e një qenieje njerëzore. Krimi në fjalë është kryer me qëllim. Rrethanat rënduese janë të shumta dhe shumë të fuqishme, siç do të adresohen më poshtë. Pasojat e shkaktuara viktimës dhe familjes së saj nuk kanë mund të jenë më të rënda sesa kaq. Prandaj, kolegji i apelit është i mendimit se dënimi me burgim afatgjatë në kohëzgjatje prej 21 deri në 40 vjet është dënim i domosdoshëm.

Shkalla e fajit të të pandehurit është në veçanti e lartë. Dashja për ta vlarë viktimën nuk kishte ndodhur krejt papritmas, por përgjatë një periudhe të caktuar, së paku nga momenti kur viktimia ishte futur në pyll. I pandehuri kishte pasur kohë për të reflektuar rreth qëllimeve të tija dhe për t'iu shmangur veprimit kriminal. Përkundër kësaj, ai kishte këmbëngulë në të, duke e nxjerrë kështu në pah energjinë e tij të fuqishme kriminale. Në raport me viktimën, ai ka pasur superioritet fizik dhe psikologjik, ndërsa viktimia i besonte si dikujt me të cilin e mbante një lidhje dashurie. Viktimia ishte në një pozitë të tillë në të cilën ajo nuk mund të mbrohej apo të thërriste për ndihmë.

Faktorët individualë parandalues janë në nivelin normal. I pandehuri ka familjen e cila varet prej tij dhe se kjo rrethanë është me rëndësi që ai ta ndjejë nevojën ta kërkojë rehabilitimin e vetes.

Faktorët e përgjithshëm parandalues, janë megjithatë, në shkallë relativisht të lartë. Pengimi i personave të tjerë për të mos kryer vepra penale si kjo duhet të ndikohet nga sanksioni i caktuar ndaj të pandehurit. Afati i burgimit duhet të jetë më i lartë sesa minimumi prej 21 vjetësh për shkak se përndryshe nuk do të plotësohej qëllimi i parandalimit të përgjithshëm.

Kolegji i apelit konsideron se 22 vjet burgim nuk i pasqyrojnë në mënyrë adekuate rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese të pranishme në këtë lëndë.

Si rrethana rënduese, kolegji i apelit i konstaton këto rrethana:

- Ka pasur paramendim të krimit. I pandehuri ka filluar t'i dërgojë porosi kërcënuese viktimës dy apo tre ditë para se ta vriste. Kjo nuk do të thotë se tashmë kishte vendosur ta vriste viktimën, porse e kishte lënë idenë në fjalë të zhvillohej në mendjen e tij pa e luftuar në mënyrë adekuate. Pasi ishte takuar dhe kishte diskutuar me viktimën, i pandehuri e kishte çuar me makinë tek një pyll, goxha larg rrugës kryesore dhe shtëpive. Trupi gjykues i shkallës së parë kishte vërtetuar se vetëm pasi viktimë dhe i pandehuri kishin arritur në fshatin Zllatar, ai kishte vendosur ta vriste (paragrafi 98). Megjithatë, kolegji i apelit konstaton se është e pakontestueshme se kur e kishte çuar viktimën me makinë në një vend kaq të largët pa ndonjë arsye tjetër të besueshme, edhe pse ka pasur mundësi të mos kishte vendosur akoma, atij tashmë po i formësohej në mendje ideja e tillë. Për më tepër, ai e kishte në pronësi brenda në makinë edhe atë sendin me të cilin e kishte vrarë viktimën më vonë. Derisa e voziste atë tek vendi në fjalë ai e kishte mundësinë për të reflektuar rreth asaj se çfarë do të bënte dhe pastaj ta lëshonte viktimën. Por nuk e bëri këtë.

- I pandehuri ishte në kontroll të plotë të veprimeve të veta dhe mund të reflektonte rreth asaj se çfarë ishte duke bërë. Është e vërtetë se ishte i trazuar dhe se veprimet e tija ndikoheshin nga ndjenjat që i kishte. Megjithatë, provat tregojnë se ai nuk ishte trazuar në atë masë sa të privohej nga vullneti apo aftësia për ta kuptuar domethënien e veprimeve të tija. Ai u mundua ta fshihte identitetin e viktimës pasi e kishte vrarë, gjë e cila tregon se ka qenë shumë i vetëdijshëm se çfarë ishte duke vepruar.

- I pandehuri kishte superioritet fizik dhe psikologjik mbi viktimën. Ai në një mënyrë ishte ngarkuar nga i shoqi i saj me detyrën e përkujdesjes për të, si familjar më i vjetër që ishte, duke ia siguruar transportin për orët e saja të gjuhës së huaj, dhe duke e paguar për këtë punë. Ata kishin një lidhje dashurie. Ai i kishte 39 ndërsa ajo 23. Të gjithë këta faktorë janë të mjaftueshëm për ta vërtetuar se viktimë i besonte të pandehurit prandaj derisa ai po e çonte në vendin e vrasjes, ajo nuk e priste se çfarë do t'i ndodhte.

- Viktimë ishte e moshës së re. Edhe pse vlera e jetës së njeriut është e pakompensueshme, fakti se viktimë ende nuk i kishte mbushur 23, ka një rëndësi të madhe. Ajo ishte privuar nga jeta në çastin kur ende nuk e kishte pasur shansin për ta shijuar dhe për t'u kënaqur me të, si gjithë të tjerët. Humbja për familjen e saj prandaj ka qenë edhe më e madhe për shkakun se ajo ishte shumë e re.

- Krimi është kryer me brutalitet të tepruar. Duke e lexuar raportin e autopsisë, duke i pasur parasysh numrin e madh të goditjeve dhe intensitetin e tyre, kolegji i apelit vjen në përfundimin se i pandehuri në vazhdimësi e kishte goditur në kokë, që ishte e panevojshme për të arritur deri tek vrasja.

Si rrethana lehtësuese, kolegji i apelit gjen se:

- I pandehuri nuk ka qenë më herët i dënuar. Ky faktor është i rëndësishëm për caktimin e mundësive të rehabilitimit social në një shkallë më të lartë.

- I pandehuri ka qenë bashkëpunues me organet hetimore qysh në fillim të procedurës dhe atë në masë të rëndësishme. E ka pranuar se çfarë ka bërë dhe e ka shpjeguar në hollësi. Kjo është me rëndësi sepse tregon se ka qenë në gjendje që të përjetojë një masë të keqardhjes dhe vetëcenzurës. Kjo po ashtu ka rëndësi për t'i vlerësuar mundësitë e rehabilitimit të tij në shoqëri.

- I pandehuri është person familjar, duke e përfshirë këtu gruan, fëmijët dhe prindërit e moshuar, të cilët janë të varur prej tij.

Kolegji i apelit e ka diskutuar thellë çështjen e dënimit. Siç është theksuar më lart, është konstatuar se 22 vjet burgim janë të pamjaftueshme për të reflektuar rreth qëllimit të parandalimit të përgjithshëm dhe të peshimit të rrethanave rënduese. Megjithatë, kolegji po ashtu ka konsideruar se nuk do të ishte e drejtë nëse sanksioni do të shqiptohej shumë mbi kufirin minimal, pasi që me këtë mundësitë e rehabilitimit do të dëmtoheshin së tepërmi. Nuk mund të konsiderohet i përmbushur qëllimi rehabilitues po qe se të pandehurit do t'i duhej ta kalonte gati tërë pjesën e mbetur të jetës së tij në burg. Për këtë arsye, kolegji i apelit konstaton se dënim adekuat dhe i drejtë është që të pandehurit në fjalë t'i shqiptohet dënimi prej 25 vjetësh burgim.

Për arsyet e dhëna, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv.

Kryetari i kolegjit

---

Manuel Soares, gjyqtar i EULEX-it

Anëtarja e kolegjit

---

Mejreme Memaj, gjyqtare e Gjykatës së Apelit

Anëtari i kolegjit

---

Xhevdet Abazi, gjyqtar i Gjykatës së Apelit

Procesmbajtëse

---

Vjollca Kroçi – Gërxhaliu, këshilltare ligjore e EULEX-it